

QELIZAT JAPIN INDET – ORGANET – ORGANIZMIN

1. Përshkruaj grupet e qelizave që përbëjnë një ind!

Indet janë grupe qelizash, që duken njësoj, kanë ndërtim të njëjtë, origjinë të njëjtë dhe kryejnë funksion të njëjtë në organe. P.sh. qelizat e indeve që përbëjnë muskujt kontraktues të zemrës apo qelizat e kuqe të gjakut që marrin dhe bartin oksigjenin.

2. Shpejgo përbërjen e një organi!

Numër i caktuar i indeve përbëjnë një organ. Çdo ind ka funksion dhe ndërtim të caktuar, por të gjitha së bashku veprojnë si një tërësi e pandarë. Dhe kryejnë funksione që janë tipike për atë organ. Kështu kërcelli është një organ i përbërë prej indeve por të gjitha së bashku ndihmojnë në qëndrimin e drejtë të bimës transportimin e ujit dhe të lëndëve minerale dhe bartjen e tyre në orgne të tjera të bimës.

3. Trego si një organizëm arrin ti kryejë të gjitha proceset e ndryshme të jetës në të njëjtën kohë!

Një organizëm është kompleks për të kryer të gjitha funksionet jetësore të nevojshme. Organizmi përbëhet prej organeve ku secili kryen funksionin e vet. Organet përbëjnë sistemin e organeve kështu që shumë funksione janë të ndërlidhura dhe të kordinuara.

4. Krahaso sistemet e organeve në mes bimëve dhe shtazëve?

Sistemi i qarkullimit të gjakut - shtazët kanë zemrën e cila pompon gjak, i cili qarkullon përmes arterieve dhe venave. Kurse bimët ujin dhe lëndët ushqyese i thithin nga dheu përmes enëve të veçanta të tufës përquese (kliemës) të sistemit përçues, i bartin në gjithë bimën. Kurse lëndët organike që i krijojnë vetë përmes fotosintezës i bartin përmes enëve të tjera të veçanta (floemës).